

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

Adoleshentët


MICS

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë



## Popullsia adoleshente: Moshë 10-19


### Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë së popullsisë së ekonomive familjare



Kjo pasqyrë e shkurtër informative e mirëqenies së adoleshentëve është e organizuar rreth fushave kryesore prioritare për adoleshentët:

- Çdo adoleshent mbijeton dhe zhvillohet
- Çdo adoleshent mëson
- Çdo adoleshent është i mbrojtur nga dhuna dhe shfrytëzimi
- Çdo adoleshent jeton në një mjedis të sigurt dhe të pastër
- Çdo adoleshent ka mundësi të barabarta në jetë

### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




## Çdo adoleshent mbijeton dhe zhvillohet

Adoleshenca sipas disa matjeve është periudha më e shëndetshme gjatë jetës, megjithatë mund të shënojë gjithashtu shfaqjet e para të çështjeve që mund të kenë efekte gjatë gjithë jetës në shëndet dhe mirëqenie, siç janë sjellja e pasigurt seksuale, lindja e hershme e fëmijëve dhe keqpërdorimi i substancave. Sidoqoftë, ndërhyrjet shëndetësore gjatë kësaj periudhe tregohet se kanë efekte afatgjata. Qasja në metodat e duhura kontraktive është thelbësore për të parandaluar shtatzëninë në adoleshencë dhe pasojat e lidhura me të, duke lejuar adoleshentët të kalojnë në moshën madhore me aftësinë për të planifikuar shtatzënitë e tyre dhe të jetojnë jetë të shëndetshme dhe produktive.

### Shkalla e lindjeve tek adoleshentët: SDG 3.7.2


Kosovë



Shkalla e fertilitetit specifike për moshën për vajzat e moshës 15-19 vjeçe: numri i lindjeve të gjalla në 3 vitet e fundit, i pjesëtuar me numrin mesatar të femrave në atë grupmoshë gjatë së njëjtës periudhë, e shprehur për 1,000 femra  
( ) Shifrat që bazohen në 125-249 persona-vite të papeshuara të ekspozimit

### Përdorimi i kontraktiveve moderne, nevoja e plotësuar dhe kërkesa e plotësuar për metodat moderne: SDG 3.7.1

Kosovë




Legend: ■ Moderne ■ Nevojë e plotësuar ■ Kërkesë e plotësuar (metodë moderne) SDG 3.7.1

Përqindja e femrave të martuara apo në bashkëjetesë të moshës 15-19 vjeçe dhe 20-24 vjeçe që përdorin (ose partneri i së cilës përdor) metodën kontraktive, përqindja me nevojën e plotësuar për kontraktive dhe përqindja e kërkesës të plotësuar për metoda moderne të planifikimit familjar, sipas grupmoshës  
( ) Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara  
(\*) Shifra që bazohen në më pak se 25 raste të papeshuara

### Shkalla e lindjeve tek adoleshentët: SDG 3.7.2


Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Shkalla e fertilitetit specifike për moshën për vajzat e moshës 15-19 vjeçe: numri i lindjeve të gjalla në 3 vitet e fundit, i pjesëtuar me numrin mesatar të femrave në atë grupmoshë gjatë së njëjtës periudhë, shprehur për 1,000 femra  
( ) Shifrat që bazohen në 125-249 persona-vite të papeshuara të ekspozimit

### Përdorimi modern i kontraktiveve, nevoja e plotësuar dhe kërkesa e plotësuar për metoda moderne: SDG 3.7.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Legend: ■ Moderne ■ Nevojë e plotësuar ■ Kërkesë e plotësuar (metodë moderne) SDG 3.7.1

Përqindja e femrave të martuara apo në bashkëjetesë të moshës 15-19 vjeçe dhe 20-24 vjeçe që përdorin (ose partneri i së cilës përdor) metoda kontraktive, përqindja me nevojën e plotësuar për kontraktive dhe përqindja e kërkesës të plotësuar për metoda moderne të planifikimit familjar, sipas grupmoshës  
( ) Shifrat që bazohen në 25-49 raste të papeshuara

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovë dhe mostrën për MICS për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e llogaritura të pasurisë pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikun.


## Çdo adoleshent mëson

### Shkathësitë themelore të leximit Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 7-14 vjeç, të cilët mund 1) të lexojnë 90% të fjalëve saktë në një tregim, 2) të përgjigjen në tri pyetje të të kuptuarit të drejtpërdrejt, 3) të përgjigjen në dy pyetje të të kuptuarit tërthor (inferencial)


### Shkathësitë themelore të numërimit Kosovë



Përqindja e fëmijëve nga moshja 7-14 vjeç që mund të kryejnë me sukses 1) një detyrë për leximin e numrave, 2) një detyrë për dallimin e numrave, 3) një detyrë shtesë dhe 4) një detyrë për identifikimin dhe përfundimin e modelit


Edukimi dhe përvojat cilësore në shkollë ndikojnë pozitivisht në shëndetin fizik dhe mendor, sigurinë, angazhimin qytetar dhe zhvillimin shoqëror. Megjithatë, adoleshentët mund të përballen gjithashtu me rrezikun e braktisjes së shkollës, martesës së hershme ose shtatzënisë, ose detyrohen të punojnë para kohe.

### Shkathësitë themelore të leximit Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve nga moshja 7-14 vjeç, të cilët mund 1) të lexojnë 90% të fjalëve saktë në një tregim, 2) të përgjigjen në tri pyetje të të kuptuarit të drejtpërdrejt, 3) të përgjigjen në dy pyetje të të kuptuarit tërthor (inferencial)


### Shkathësitë themelore të numërimit Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve nga moshja 7-14 vjeç që mund të kryejnë me sukses 1) një detyrë për leximin e numrave, 2) një detyrë për dallimin e numrave, 3) një detyrë të mbledhjes dhe 4) një detyrë për identifikimin dhe përfundimin e modelit


Të dhënat për shkathësitë e leximit dhe numërimit në MICS grumbullohen përmes një metode së vlerësimit direkt. Moduli i të mësuarit themelor kap informacionin mbi të mësuarit e hershëm të fëmijëve në lexim dhe matematikë në nivelin e klasës së 2-të në arsimin fillor.

### Shkalla e vijueshmërisë së shkollës Kosovë



Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar), sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë

### Shkalla e vijueshmërisë së shkollës Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Shkalla neto e vijueshmërisë (e adaptuar), sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë

# Çdo adoleshent mbrohet nga dhuna dhe shfrytëzimi

## Martesat e fëmijëve: SDG 5.3.1


Kosovë



Përqindja e femrave të moshës 20 deri në 24 vjeçe që ishin martuar për herë të parë ose ishin në bashkëjetesë para moshës 15 vjeçare dhe para moshës 18 vjeçare, sipas vendbanimit

## Martesat e fëmijëve: SDG 5.3.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e femrave të moshës 20 deri në 24 vjeçe që ishin martuar për herë të parë ose ishin në bashkëjetesë para moshës 15 vjeçare dhe para moshës 18 vjeçare, sipas vendbanimit

Adoleshenca është periudhë me rrezik të shtuar ndaj formave të caktuara të dhunës dhe shfrytëzimit. Fillimi i pubertetit shënon një tranzicion të rëndësishëm në jetën e vajzave dhe djemve ku gjinia, seksualiteti dhe identiteti seksual fillojnë të kenë një rëndësi më të madhe, duke rritur ndjeshmërinë ndaj formave të veçanta të dhunës, veçanërisht për vajzat adoleshente. Disa praktika të dëmshme tradicionale, siç është martesat e fëmijëve, shpesh ndodhin në fillimin e pubertetit. Njëkohësisht, kur fëmijët hyjnë në adoleshencë, ata fillojnë të kalojnë më shumë kohë jashtë shtëpive të tyre dhe të ndërveprojnë më nga afër me një gamë më të gjerë të njerëzve, përfshirë moshatarët dhe partnerët romantikë. Ky ndryshim në botët shoqërore është i dobishëm në shumë aspekte, por gjithashtu i ekspozon adoleshentët ndaj formave të reja të dhunës.


## Disiplinimi i fëmijëve

Kosovë


Vetëm disiplinim jo të dhunshëm




Ndëshkim fizik



Dhunë psikologjike



Çfarëdo disiplinimi i dhunshëm\*




Përqindja e fëmijëve të moshës 10 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit në muajin e kaluar, sipas llojit

\*Zbërthimi sipas moshës e SDG 16.2.1


## Disiplinimi i fëmijëve

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë


Vetëm disiplinim jo të dhunshëm




Ndëshkim fizik



Dhunë psikologjike



Çfarëdo disiplinimi i dhunshëm\*




Përqindja e fëmijëve të moshës 10 deri në 14 vjeç që kanë përjetuar ndonjë metodë të disiplinimit në muajin e kaluar, sipas llojit

\* Zbërthimi sipas moshës e SDG 16.2.1

# Çdo adoleshent mbrohet nga dhuna dhe shfrytëzimi

## Puna e fëmijëve: SDG 8.7.1


Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas moshës

## Puna e fëmijëve: SDG 8.7.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas moshës

### Përkufizimi i punës së fëmijëve

Mosha 5 deri në 11 vjeç: Të paktën 1 orë aktivitate ekonomike ose 21 orë punë të shtëpisë pa pagesë gjatë javës.

Mosha 12 deri në 14 vjeç: Të paktën 14 orë aktivitate ekonomike ose 21 orë punë të shtëpisë pa pagesë gjatë javës.


Mosha 15 deri në 17 vjeç: Të paktën 43 orë aktivitate ekonomike. Nuk ka prag për numrin e orëve të punëve të shtëpisë pa pagesë.

Aktivitetet ekonomike përfshijnë punë të paguar ose të papaguar për dikë që nuk është anëtar i ekonomisë familjare, punë për fermën familjare ose biznesin. Punët e shtëpisë përfshijnë aktivitate siç janë gatimi, pastrimi ose kujdesi për fëmijët.

Shënim: përkufizimi i treguesit për punën e fëmijëve ka ndryshuar gjatë implementimit të raundit të gjashtë të MICS. Ndryshimet përfshijnë pragjet specifike të moshës për punët e shtëpisë dhe përjashtimin e kushteve të rrezikshme të punës. Derisa koncepti i përgjithshëm i punës së fëmijëve përfshin kushtet e rrezikshme të punës, përkufizimi i punës së fëmijëve i përdorur për raportimin e SDG-ve nuk i përfshinë këto.

## Puna e fëmijëve sipas llojit të aktivitetit: SDG 8.7.1


Kosovë



Përqindja e adoleshentëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe sipas moshës  
Shënim: Këto të dhëna pasqyrojnë përqindjet e fëmijëve të angazhuar në aktivitate në ose mbi pragjet specifike të moshës të përshkruara në rubrikën e përkufizimeve.

## Puna e fëmijëve sipas llojit të aktivitetit: SDG 8.7.1

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e adoleshentëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe sipas moshës  
Shënim: Këto të dhëna pasqyrojnë përqindjet e fëmijëve të angazhuar në aktivitate në ose mbi pragjet specifike të moshës të përshkruara në rubrikën e përkufizimeve.

# Çdo adoleshent ka mundësi të barabarta në jetë


## Diskriminimi dhe ngacmimi

Kosovë


Etniciteti ose origjina e imigrimit




Orientimi seksual




Religjioni ose besimi




Gjinia



Mosha



Aftësia e kufizuar




Përqindja e vajzave dhe djemve adoleshentë të moshës 15-19 vjeç të cilët në 12 muajt e fundit janë ndjerë të diskriminuar ose të ngacmuar për arsye të ndryshme


## Diskriminimi dhe ngacmimi

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë


Etniciteti ose origjina e imigrimit




Orientimi seksual




Religjioni ose besimi




Gjinia



Mosha



Aftësia e kufizuar




Përqindja e vajzave dhe djemve adoleshentë të moshës 15-19 vjeç të cilët në 12 muajt e fundit janë ndjerë të diskriminuar ose të ngacmuar për arsye të ndryshme

Arritja e progresit dhe rezultateve të qëndrueshme në lidhje me barazinë kërkon një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Në thelb të kornizës ligjore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut është parimi i mos-diskriminimit, me instrumente për të luftuar format specifike të diskriminimit, përfshirë atë ndaj femrave, popujve autoktonë, migrantëve, pakicave, personave me aftësi të kufizuara dhe diskriminimin bazuar në racë dhe fe, ose orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Derisa adoleshentët fillojnë të formojnë më shumë identitetin individual, diskriminimi shpesh mund të bëhet më i theksuar, duke marrë formën e ngacmimit, bulizmit ose përgjithësisht nga aktivitetet e caktuara. Njëkohësisht, hulumtimi ka treguar se diskriminimi gjatë adoleshencës ka një efekt të veçantë në hormonet e stresit, duke ndikuar potencialisht në efekte anësore të shëndetit mendor ose fizik gjatë gjithë jetës.

Fëmijët dhe adoleshentët me aftësi të kufizuara janë një nga grupet më të marginalizuara në shoqëri. Duke u përballur me diskriminimin e përditshëm në formën e qëndrimeve negative, mungesën e politikave dhe legjisacionit adekuat, adoleshentëve me aftësi të kufizuara efektivisht u ndalohej të drejtat e tyre për shëndetin, arsimin dhe madje edhe mbijetesën.

## Vështirësitë funksionale tek adoleshentët


Kosovë



Përqindja e adoleshentëve me vështirësi funksionale në të paktën një fushë, sipas moshës dhe përqindja e atyre që kanë vështirësi funksionale, sipas fushës dhe moshës

## Vështirësitë funksionale tek adoleshentët

Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e adoleshentëve me vështirësi funksionale në të paktën një fushë, sipas moshës dhe përqindja e atyre që kanë vështirësi funksionale, sipas fushës dhe moshës

# Çdo adoleshent ka mundësi të barabarta në jetë


Të dhënat e paraqitura këtu janë në nivelin e ekonomisë familjare. Dëshmitë sugjerojnë që qasja e adoleshentëve në këto shërbime është e krahasueshme me të dhënat e nivelit të ekonomisë familjare.

**Uji i pijshëm SDG 1.4:** Uji i pijshëm nga një burim i përmirësuar, me kusht që koha e grumbullimit të mos jetë më shumë se 30 minuta për një vajtje-ardhje duke përfshirë pritjen në radhë. Burimet e përmirësuara të ujit të pijshëm janë ato që kanë potencial për të dhënë ujë të sigurt për nga natyra e dizajnit dhe ndërtimit të tyre, dhe përfshijnë: ujësjellësin, pus gypi ose pompë, pus i mbrojtur, burim i mbrojtur, ujë i mbledhur nga shiu dhe ujë i paketuar ose të ofruar


**Shërbimet themelore sanitare SDG 1.4.1/6.2.1 :** Përdorimi i tualeteve të përmirësuara të cilat nuk ndahen me ekonomitë familjare tjera. Tualetet e përmirësuara janë ato të krijuara për të ndarë në mënyrë higjienike jashtëqitjet nga kontakti me njerëz dhe përfshijnë derdhjen e ujit në sistemin e kanalizimit me gypa, rezervuar septik ose nevojtoje gropë; nevojtoje gropë me ventilim, me pllakë apo me kompostim

**Lëndët djegëse të pastra SDG 7.1.2:** Mbështetja kryesore në lëndët djegëse të pastra dhe teknologjitë për gatim, ngrohje të hapësirës dhe ndriçim

## Përdorimi i ujit, kanalizimit dhe lëndëve djegëse të pastra



## Përdorimi i ujit, kanalizimit dhe lëndëve djegëse të pastra



## Mesazhet kryesore

- Adoleshentët e moshës 15-19 vjeç përbëjnë përqindjen më të madhe të popullsisë në Kosovë (10 për qind për meshkujt dhe femrat).
- Shkalla e lindjeve është dukshëm më e lartë tek vajzat adoleshente të moshës 15-19 vjeçe me nivele më të ulëta arsimit dhe atyre që jetojnë në familjet më të varfëra si në popullatën e përgjithshme ashtu edhe në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Ndërsa 15 për qind e femrave të moshës 20-24 vjeçe që janë të martuara ose në bashkëjetesë në Kosovë kanë nevojë të paplotësuar për kontracëpsion, vetëm 3 për qind përdorin metoda kontracëpsive dhe 5 për qind e kanë të plotësuar kërkesën për planifikim familjar me metoda moderne.
- Vetëm 2 nga 5 fëmijë të moshës 7-14 vjeç në Kosovë kanë shkathtësi themelore të leximit dhe shkathtësi themelore numerike.
- Përqindjet janë edhe më të ulëta në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (përkatësisht 1 në 5 dhe 1 në 10).
- Ndërsa nivelet e vijueshmërisë të shkollës fillore dhe të mesme të ulët janë mbi 90 për qind, ato bien për shkollën e mesme të lartë, veçanërisht për djemtë (84 për qind). Shkalla e vijueshmërisë në mesin e fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian është më e ulët, veçanërisht për shkollën e mesme të ulët dhe të mesme të lartë (përkatësisht rreth 60 për qind dhe 30 për qind).
- 1 në 3 femra të moshës 20-24 vjeçe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ishin të martuara ose në bashkëjetesë para moshës 18 vjeçare.
- Vetëm 1 në 4 adoleshentë të moshës 10-14 vjeç në Kosovë disiplinohen me metoda jo të dhunshme.
- Rreth 1 në 10 femra të moshës 15-19 vjeç në popullatën e përgjithshme dhe ato që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian raportuan se kishin përjetuar diskriminim dhe ngacim në baza gjinore.
- 1 në 8 femra dhe 1 në 6 meshkuj të moshës 15-19 vjeç që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përjetuan diskriminim dhe ngacim bazuar në përkatësinë etnike ose origjinën e imigrimit.
- 1 në 10 adoleshentë të moshës 15-17 vjeç në popullatën e përgjithshme dhe 2 në 10 në mesin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë vështirësi funksionale në të paktën një fushë.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë kryer në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA) dhe UN Women.

Qëllimi i kësaj pasqyre të shkurtër informative është shpërndarja e gjetjeve të zgjedhura nga MICS 2019-2020 në Kosovë dhe MICS 2019-2020 me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë lidhur me adoleshentët. Të dhënat nga kjo pasqyrë e shkurtër informative mund të gjenden në tabelat SR.4.1, TM.2.1, TM.3.1, TM.3.3, LN.2.3, LN.2.4, LN.2.6, LN.4.1A, LN.4.2A, PR.2.1, PR.3.3, PR.4.1W/M, EQ.1.2, EQ.3.1W/M, WS.3.6 dhe TC.4.7 në Raportin e Gjetjeve të Anketës (treguar me shkronjën 'R' për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë).

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në [mics.unicef.org/surveys](https://mics.unicef.org/surveys).